

Përkufizimi i pëlqimit afirmativ

Pëlqimi afirmativ është një vendim i mirinformuar, i vullnetshëm, dhe i ndërsjellë midis të gjithë pjesëmarrësve, për t'u angazhuar në aktivitet seksual. Pëlqimi mund të jepet me fjalë ose veprime, për aq kohë sa këto fjalë apo veprime krijojnë leje të qartë lidhur me gatishmërinë për t'u angazhuar në aktivitet seksual. Heshtja apo mungesa e rezistencës, në vetvete, nuk tregon pëlqim. Përkufizimi i pëlqimit nuk ndryshon në bazë të gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor ose shprehjes gjinore së një pjesëmarrësi.

Pëlqimi për çdo akt seksual apo aktivitet paraprak konsensual seksual, ndërmjet palëve apo me çdo palë, nuk përbën doemos pëlqim të ndonjë akti tjetër seksual.

Pëlqimi kërkohet pavarësisht nëse personi që fillon aktin është nën ndikimin e drogës dhe/ose të alkoolit.

Pëlqimi mund të jepet në fillim, por të tërhiqet në çdo kohë.

Pëlqimi nuk mund të jepet, kur një person është i paaftë, gjë që ndodh kur një individ i mungon aftësia për të zgjedhur me vetëdije për të marrë pjesë në aktivitet seksual. Paaftësia mund të shkaktohet nga mungesa e vetëdijes apo të qenit në gjumë, duke u kufizuar në mënyrë të pavullnetshme, ose në qoftë se një individ nuk mund të japë pëlqimin ndryshe. Në varësi të shkallës së dehjes, dikush që është nën ndikimin e alkoolit, drogës apo pijeve të tjera dehëse mund të jetë i paaftë dhe rrjedhimisht nuk është në gjendje të japë pëlqimin.

Pëlqimi nuk mund të jepet kur është rezultat i ndonjë detyrimi, kanosjeje, force, apo kërcënim për lëndimi.

Kur pëlqimi është tërhequr ose nuk mund të jepet më, duhet të ndalet aktiviteti seksual.

Amnistia nga akuzat për sjellje nën përdorimin e drogës dhe të alkoolit

Shëndeti dhe siguria e çdo studenti në Rockland Community College është me rëndësi të madhe. RCC e kupton se studentët që kanë qenë duke pirë dhe/ose përdorur droga (qoftë nëse një përdorim i tillë është i vullnetshëm ose i pavullnetshëm) në kohën kur ndodh dhuna, duke përfshirë, pa u kufizuar vetëm në të, dhunë në familje, dhunë nga partneri intim, ndjekje obsesive apo sulm seksual, mund të hezitojnë të raportojnë incidente të tilla, për shkak të frikës për pasojat e mundshme për sjelljen e tyre. RCC inkurajon fort studentët të raportojnë dhunën në familje, dhunën nga partneri intim, ndjekjen obsesive ose sulmet seksuale te zyrtarët e institucionit. Një kalimtar që vepron në mirëbesim ose një individ raportues që vepron në mirëbesim, duke zbuluar çdo incident dhune në familje, dhune nga partneri intim, ndjekjeje obsesive ose sulmi seksual te zyrtarët e RCC ose zbatuesit e ligjit, nuk preken nga kodi i sjelljes i RCC's për shkelje të rregullave mbi përdorimin e alkoolit dhe/ose të drogës, të ndodhura gjatë apo rreth kohës së kryerjes së dhunës në familje, dhunës nga partneri intim, ndjekjes obsesive apo sulmit seksual.

Karta e të drejtave të studentit

Të gjithë studentët kanë të drejtë:

Të raportojnë te zbatuesit vendorë të ligjit dhe/ose policia e shtetit;

Të kenë trajtim serioz të zbulimit të dhunës në familje, dhunës nga partneri intim, ndjekjes obsesive dhe sulmeve seksuale;

Të marrin një vendim nëse do të zbulojnë ose jo një krim apo shkelje dhe të marrin pjesë në procesin gjyqësor ose të sjelljes dhe/ose në procesin e drejtësisë penale, pa presion nga institucioni;

Të marrin pjesë në një proces të drejtë, të paanshëm dhe që siguron njoftim të përshtatshëm dhe një mundësi domethënëse për t'u dëgjuar;

Të trajtohen me dinjitet dhe të marrin kujdes shëndetësor dhe shërbime këshillimi të sjellshme, të drejta dhe të respektueshme, nga institucioni, kur janë të disponueshme;

Të jenë të lirë nga çdo sugjerim se individ raportues është në faj kur janë kryer këto krime dhe shkelje, ose që duhet të kishte vepruar në një mënyrë tjetër për të shmangur krime ose shkelje të tilla;

Të përshkruajnë incidentin në sa më pak përfaqësues institucionalë dhe mos t'u kërkohet përsëritje e panevojshme e përshkrimit të incidentit.

Të jenë të mbrojtur nga institucioni prej shpagimit nga ndonjë student, i akuzuar dhe/ose i paditur, dhe/ose miqtë, familja dhe të njohurit e tyre, brenda juridiksionit të institucionit;

Të kenë mundësi në të paktën një nivel apelimi të një vendimi;

Të shoqërohen nga një këshilltar i zgjedhur i cili mund të ndihmojë dhe këshillojë një individ raportues, të akuzuar ose të paditur gjatë procesit gjyqësor ose për sjelljen, duke përfshirë të gjitha takimet dhe seancat dëgjimore të lidhura me një proces të tillë;

Të ushtrojnë të drejta civile dhe të praktikojnë fenë, pa ndërhyrje nga drejtësia hetimore, penale ose gjyqësore, apo procesi për sjelljen nga institucioni.

Të drejtat zbatohen pavarësisht racës, ngjyrës, origjinës kombëtare, fesë, besimit, moshës, aftësisë së kufizuar, gjinisë, identitetit ose shprehjes gjinore, orientimit seksual, statusit familjar, shtatzënisë, karakteristikave gjenetike predispozuese, statusit ushtarak, statusit viktimë e dhunës në familje, ose dënim penal dhe pa marrë parasysh nëse krimi apo shkelja ndodh në kompleksin universitar, jashtë kompleksit apo ndërsa studion jashtë vendit.

Ju keni të drejtë të raportoni në policinë e universitetit ose sigurinë e kompleksit universitar, zbatuesit vendorë të ligjit dhe/ose policinë e shtetit, ose të zgjidhni të mos raportoni; të raportoni incidentin tek institucioni juaj; të jeni të mbrojtur nga institucioni prej hakmarrjes për raportim të një incidenti; dhe të merrni ndihmë dhe burime nga institucioni juaj.